

Vit i ri por Tirane e vjeter

nga Albaniassocer

E shtunë, 24 Janar 2015 16:20



Tirana-Apolonia 2-0 Ndikumana 46,64

Tirane e vjeter per rezultatet por edhe per 11-shin fillestare ku vetem Muzaka ishte lojtar i ardhur ne Janar.

Ekipi bardheblu e ka hapur vitin e ri 2015 me nje tjeter fitore. Kete radhe tiranasit kane mundur 2-0 Apolonine ne fushen e Niko Dovanes. Ishte nje Tirane cinike dhe qe ne fushen e lojes kishte vetem nje lojtar te ri, Gjergji Muzaken. Magani e kuptoj shpejt per fatin e Tiranes qe Ndikumana duhej sezben ne fushe dhe e futi ne minuten 38 ne vend te Hyshmerit. Burundasi e shperblej trajnerin me dygoleshin e fitores. Bardheblute paten edhe raste te tjera per shenim por nuk arriten dot ta thellonin rezultatit. Edhe Apolonia e trajnerit te ri, Artan Mergjyshi, pati disa raste por lojtaret e saje nuk ishin te sakte para Frasherit.